

RAPORT
VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS
PER PRODHIMIN E BETONIT



Lagjia "10 Koriku"
Ish Poligoni I Ndermarrjes " Perlat Rexhepi "
Vlore

Studio "**COMERCIR**" sh.p.k
Msc. Ing. Apostol QIRKO
Msc. Ing. Athinta QIRKO

A handwritten signature in blue ink, followed by the year '2014'. Below the signature is a blue circular stamp. The stamp contains the following text: 'COMERCIR SH.P.K STUDIO MJEDISORE', 'NIPT: K36805204D', 'NR. LIÇ LN-7403-01-2014', and 'A.QIRKO ALBANIA'.

Vlore, 13.10.2014

PERMBAJTJA

HYRJE Prezantim i shkurter
 Karakteristikat kryesore

SEKSIONI 1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- 1.1. Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit
- 1.2. Kerkesat mbi perdorimin e tokes
- 1.3. Procesi i punes dhe karakteristikat operative te objektit
- 1.4. Mbetjet dhe emetimet ne mjedis

SEKSIONI 2 PERSHKRIMI I VENDIT DHE I MJEDISIT TE TIJ

- 2.1. Popullsia ekzistuese ne qytetin e Vlores
- 2.2. Flora, faune dhe habitatet
- 2.3. Tokat, kategoria e tokes gjeologjia dhe morfologjia
- 2.4. Cilesia e tokes
- 2.5. Uji , akuiferet shkarkimet e mundshme ekzistuese
- 2.6. Ajri, cilesia e ajrit, faktoret klimatike
- 2.7. Trashegimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike
- 2.8. Pejsazhi

SEKSIONI 3 VLERESIMI I NDIKIMEVE

- 1.1. Ndikimet ne popullsi
- 3.2. Ndikimet vizuale te aktivitetit ne rajonin perreth dhe ne pejsazh
- 3.3. Nivelet dhe ndikimet e emetimeve nga aktiviteti gjate funksionimit normal
- 3.4. Nivelet dhe ndikimet e zhurmave te shkaktuara nga aktiviteti
- 3.5. Ndikimet e aktivitetit mbi rruget dhe transportin lokal
- 3.6. Ndikimet e aktivitetit mbi ndertesat, thesarin historik dhe arkitektonik, veçorite

arkeologjike dhe shqetesime te tjera njerezore

- 3.7. Humbje dhe demtime tek habitatet dhe speciet e tyre qofshin bime apo kafshe
- 3.8. Humbje dhe demtime ne tipare gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike
- 3.10. Ndikime fizike te aktivitetet (ndryshimi ne topografine lokale, humbja e stabilitetit te tokes, erozioni i tokes etj...)
- 3.11. Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitime ne toke, ne vendin e aktivitetit dhe ne zonen perreth
- 3.12. Ndikimet e perdorimit te tokes/burimeve
- 3.13. Efektet e aktivitetit mbi drenazhim
- 3.14. Ndryshime ne tipare te tjera hidrografike
- 3.15 Ndikime ne hidrologjine bregdetare dhe grykederdhjes se lumenjve
- 3.16. Ndikimet e ndotesve, mbetjeve etj ne cilesine e ujit
- 3.17. Niveli dhe perqendrimi i emetimeve kimike dhe efekteve mjedisore te vecanta
- 3.18. Ererat qe perhapen
- 3.19. Ndikimet nga trafiku (rruga , hekurudha , ajri , uji ,) qe lidhen me projektin .
- 3.20. Ndikimet e lindura nga grumbullimi dhe konsumimi i materialeve , ujit , energjise ose burimeve te tjera si pasoj e projektit .
- 3.21. Ndikimet e projekteve te tjera qe e shoqerojne si per shembull rruget e reja , kanalet e ujrave te zeza , banesat , linjat e energjise , nafte dhe gazsjellese , telekomunikacionit , etj
- 3.22. Ndikimet shoqeruese te projektit me projekte te tjera ekzistuese ose te propozuara
- 3.23. Ndikimet sekondare qe rezultojne nga nderveprimi i ndikimeve te tjera direkte te listuara me siper

SEKSIONI 4 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

PREZANTIM I SHKURTER

Vendndodhja Linja e prodhimit te betonit ndodhet ne lagjen"10 Korik" Ish Poligoni i Ndermarrjes "Perlat Rexhepi", Vlore

Pronari Arjan Memetaj

Numer identifikimi (NIPT): K26820201H.

KARAKTERISTIKAT KRYESORE

Natyra e veprimtarise: Prodhim betoni marka 200, marka 250, marka 300, marka 350, marka 400

Lenda e pare: Inerte te perpunuara

Kapaciteti prodhues: 40 m²/ore

Siperfaqja sheshit: S= 2300 m²

Siperfaqja e ndertimit: S= 300 m²

Procesi: Zinxhir

Fuqia e instaluar: 40 kw

Orari i punimit: Punohet pergjithesisht me orare te zgjatura ne te dy turnet e dites, ne pritshmeri te paraqitjes se klienteles

Numeri i punonjesve: Te punesuar jane 6 persona

SEKSIONI I

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1. QELLIMI DHE KARAKTERISTIKAT FIZIKE TE PROJEKTIT

Ndertimi i kesaj linje ka per qellim te realizoj prodhimin e betonit te markave te ndryshme. Ky prodhim qe perdoret ne industrin e ndertimit si ne objektet sociale dhe ato industriale eshte i markave te ndryshme; marka 200, marka 250, marka 300, marka 350, marka 400. Keto lloj marka betoni perdoret ne lidhjen e elementeve te vecate si tulla, blloqe betoni, gurje artificial, pllaka poroze dhe jo poroze te cdo lloj dimensionin duke ruajtur cilesine ndaj sizmicitetit si dhe ndaj ujerave sulfate te cilat shkaktojne demtimin e betonit te markave te ndryshme. Po keshtu cilesia e betonit duhet te jete e tille qe te rezistoj temperaturave dhe agjenteve atmosferike. Ne kete linje jane punesuar rreth 6 punojes te cilet jane marre ne bashkpunim ne komunitetin aty afer ne te cilen po kryhet aktiviteti. Ne kete personel perfshihet dhe personeli administrativ dhe ai teknik i kualifikuar .

1.2 KERKESAT MBI PERDORIMIN E TOKES

Objekti eshte ndertuar ne nje siperfaqe trualli prej 2300 m² (trualli i marr ne pronesi) ndodhet ne lagjien "10 Korriku" ne zonen ne ish poligonin e ndermarrjes " Perlat Rexhepi ", Vlore.

Pjeset perberese te kesaj linje jane :

Sheshi i prodhimit me nje siperfaqe prej 2300 m², ne te cilet jane montuar linja e pergatitjes se betoneve. Ne kete ambient perfshihen dhe sheshi i depozitimit te lendeve inerte te perpunuar qe furnizohet (inerte lumi te perpunuara)

Godina me nje siperfaqe rreth 300 m² e cila ka aparaturat e komandimit te kesaj linje .Projekti ka parashikuar paisjet e te gjitha objektit me kanalizimet e nevojshme te ndara vecmas si per ujerat e sherbimeve ne teknologji ashtu dhe per nevojat sanitare. Uji teknologjik sigurohet nga pusi i hapur nga pronari i kesaj shoqerie. Shkarkimi i ujerave te bardhave eshte projektuar nepermjet kanaleve te derdhet ne kanalet e ujerave te bardha te kesaj zone duke ndertuar nje grop sedimentimi perpara se te shkojne ne keto kanalizime. Kjo siperfaqe ku eshte ndertuar ky objekt lidhet me rrugen kryesore.

1.3. PROCESI I PUNES DHE KARAKTERISTIKAT OPERATIVE TE OBJEKTIT

Linja e prodhimit te betonit perbehet nga :

- Vendi i depozitimit te materialeve inerte
- "Pandus" per transportin e inerteve ne bunkerin e inerteve
- Transportieret e inerteve
- Sillosi i cimentos
- Depozite e ujit

- Salla e komandimit
- Zyrrat (Magazine)

KARAKTERISTIKAT E LINJES DHE SKEMA E PROCESIT TE PRODHIMIT .

Karakteristikat dhe sasia e lendeve te para ndihmese.

Produkti i gatshem qe do te prodhohet eshte betoni i markave te ndryshme.

Ne fillim eshte nje perzierje rere me zall i permasave te ndryshme dhe te perqindjeve te ndryshme te cilave u hidhet uje, dhe me autobetoniere behet perzierja deri sa te veje tek konsumatori. Certifikata e analizave te ketyre lendeve tregon se keto lende plotesojne standartin teknik te perdorimit ne industrine e materialeve te ndertimit per prodhimin e betoneve perdoret lende inerte te perpunuara ne linjat e inerteve te mara nga kariera qe posedon vete kjo shoqeri.



Inertet e perpunuara lumore me granulometri te nryshme qe sherbejne si lende e pare per prodhimin e betoni

Analizat e reres se fraksionit te imet qe perdoret ne kete proces teknologjik ka keto tregues :

Pesha specifike 2.58 -2.6

Lageshtia Varion sipas stineve deri ne 12 %

Aciditeti dhe alkaliteti (Ph 6-6.5)

Fortesia 900-1350 kg/cm²

Persa i takon analizave te perberjes se cimentos, cdo prodhim cimentoje blihet me certifikaten e saj brenda standarteve sipas markave te betonit.

Ky proces eshte nje perzierje rere guri i coptuar te permasave te ndryshme te cileve u shtohet uji dhe cimentoja kur nepermjet autobetonieres sic e theksuam me larte behet perzierja deri sa te veje te konsumatori .

Per betone mbi baze guri jane keto perzierje.

Betoni eshte i markave te ndryshme .

Betoni i markes 200

Cimento tipo cimento 42.5II /AI Pesha 313 Kg/m3		
Diametri maksimal		31.5mm
Agregati	%	Sasi ne peshe
Rere guri	47%	832 kg/m3
Granil 0.5-10 mm	15%	250 kg/m3
Granil 10-20mm	38%	636 kg/m3
Sasia e ujit te pergjithshem		251 l/m3
Raportit ujit cimentos (a/c)		0.8
Pesha specifike e perzierjes		2.282 kg/m3
Klasa e konstidences		S5

Betoni i markes 250

Cimento tipo cimento 42.5II /AI Pesha 347 Kg/m3		
Diametri maksimal		31.5mm
Agregati	%	Sasi ne peshe
Rere guri	46%	800kg/m3
Granil 0.5-10 mm	15%	245kg/m3
Granil 10-20mm	39%	642 kg/m3
Sasia e ujit te pergjithshem		251 l/m3
Raportit ujit cimentos (a/c)		0.72
Pesha specifike e perzierjes		2.285 kg/m3
Klasa e konstidences		S5

Betoni i markes 300

Cimento tipo cimento 42.5II /AI Pesha 381Kg/m3		
Diametri maksimal		31.5mm
Agregati	%	Sasi ne peshe
Rere guri	45%	768kg/m3
Granil 0.5-10 mm	14%	225 kg/m3
Granil 10-20mm	41%	662 kg/m3
Sasia e ujit te pergjithshem		251 l/m3
Raportit ujit cimentos (a/c)		0.66
Pesha specifike e perzierjes		2.287 kg/m3
Klasa e konstidences		S5

Betoni i markes 350

Cimento tipo cimento 42.5II /Al Pesha 417 Kg/m3		
Diametri maksimal 31.5mm		
Agregati	%	Sasi ne peshe
Rere guri	44%	736kg/m3
Granil 0.5-10 mm	14%	220 kg/m3
Granil 10-20mm	42%	665 kg/m3
Sasia e ujit te pergjithshem		251 l/m3
Raportit ujit cimentos (a/c)		0.6
Pesha specifike e perzierjes		2.289 kg/m3
Klasa e konstitences		S5

Betoni i markes 400

Cimento tipo cimento 42.5II /Al Pesha 455 Kg/m3		
Diametri maksimal 31.5mm		
Agregati	%	Sasi ne peshe
Rere guri	43%	704 kg/m3
Granil 0.5-10 mm	14%	216 kg/m3
Granil 10-20mm	43%	666 kg/m3
Sasia e ujit te pergjithshem		251 l/m3
Raportit ujit cimentos (a/c)		0.55
Pesha specifike e perzierjes		2.292 kg/m3
Klasa e konstitences		S5

Ne betone mbi bazen e inereve te limit te perpunuara ne linjat e inerteve .

1. Marka 100-1ton(rere40% ,zhavor 60%)220 kg Cimento .
2. Marka 150-1ton(rere40% ,zhavor 60%)+268 kg Cimento .
3. Marka 200-1ton(rere40% ,zhavor 60%)+288 kg Cimento .
4. Marka 300-1ton(rere40% ,zhavor 60%)+350 kg Cimento .

Energjia e nevojshme per kete linje prodhimi eshte siguruar me nje fuqi 40 kw i siguruar nga rrjeti elektrik i zones.



Nevojat per uje ne linje te ketij lloji ndeshen vetem ne sektorin e pergatitjes se betoneve si dhe per nevoja sanitare, sic u tha dhe me lart kjo sasi uji eshte siguruar nepermjet linjes te ngritur nga pusi i shpimit.

Per te siguruar uje te vazhdushem ne rast avarish eshte siguruar nje depozit uji qe perdoret rezerv qe ky cikel te mos nderpritet .



Pusi dhe depozita qe furnizojne proceset teknologjike me uje

Skema teknologjike e prodhimit te betoneve.

Prodhimi i betonit eshte nje proces zinxhir qe realizohet ne linjen perkatese teknologjike Kjo firme prodhuese e makinerive kryesore te linjave te prodhimit te betoneve njihet si firme prestigjioze ne mbar Evropen .

Konkrtisht linja te tilla qe ka montuar Firma "Memetaj 2002 " sh.p.k jane montuar dhe ndertuar nga specialist te specializuar per montimin e ketyre linjave. Ne baze te makinerive te zgjedhura dhe skemes se zbatuar kemi besim se kjo linje do te konkuroje denjesisht ne tregun duke relizuar prodhimin e markave te ndryshme te betoni sipas kerkesave ne teknologjine e ndertimit. Per te patur nje garanci per cilesine e betoneve dhe per mbarvajtje aktiviteti kjo firme mendon qe ne te ardhme te ngreje nje laboratore per analizen e prodhimeve te kesaj linje .

- o Skema e funksionimit te linjes per prodhimin e betonit



Lenda e pare (inerte lumore te perpunuara), cohen ne bunkeret perkatese per materiale inerte te ndara ne bokse te ndryshem me 4 dimensione :per rere 0-2mm, fraksioni 5-10mm, fraksionin 10-20mm.

Bokset e inerteve kane nje kapacitet $40m^3$, prej ketej keto fraksione kalojne ne peshoren elektronike per realizimin e recepturave sipas markes se betonit te prodhuar.



Nga peshorja elektronike materiali kalon ne perziersin i cili siguron perzierjen uniform te materialit te futur. Ketu nepermjet shnekut te cimentos shtohet sasia e cimentos duke peshuar paraprakisht me nje peshore tjetër me kapacitet 5.000kg, te komanduara sipas recepturave perkatese te markave te ndryshme te betoneve te ndrysheme. Linja ka 1 sillos me kapacitet 40 ton per depozitimin e cimentosve sipas markes se dhene me larte



.Por prej ketej me ndihmen e shnekut te hermetizuar kalon ne autobetoniere e cila xhiron me rreth 60 rrotullime ne minut ku finalizohet produkti bojaku uji + cemento. Uji meret nga rezervuari me linjet e rregullt me sistem komandimi ku sasia e ujit te nevojshem matet me kontaliter aparat mates se sasis se ujit ne litra. Pas pergatisjes se kesaj perzierjes me xhiro maksimale te autobetonieres hidhet materiali inert me komandim per hapjen e bukaportave te bokseve te peshores te materialeve inerte sipas recepturave qe

kerkon marka e betonit.

Gjithe sistemi i transportit te materialit, perzierjes dhe peshimit eshte nje sistem automatik i cili sigurohet nga vete konstruksioni i pjisjeve qe perbejne kete linje teknologjike.

- o *Skema e furnizimit me cemento*

Kjo linje eshte mjaft e thjeshte dhe realizohet nepermjet instalimit te nje sillosi i cili furnizohet nepermjet autocinternave qe transportojne cemento. Prej ketej ajo me ane te shnekut tranportohet per te peshuar dhe per tu perzier me lende te tjera (inerte) per te prodhuar marken e betonit te kerkuar nga klientet. Ne linjen e prodhimit eshte instaluar

dhe linja e prodhimit te ajerit te komprimuar per pneumotransportin e cimentos nga sillosi.

Autobetonieret (4 cop) jane ne gjendje te mire teknike dhe nuk derdhin asnje lloj materiali ne rruge. Ne pisten e depozitimit te materialeve inerte eshte instaluar nje linje uji per sperkatje per te mos lejuar ngritjen e pluhurave ne ajer.

Lendet ndihmese:

→ **Cimento**

→ **Energjia elektrike** me fuqi 40 kw merret nga rrjeti kryesor i energjise elektrike te zones perreth sipas kontrates te bere nga vet pronari i kesaj firme me CEZ.

→ **Uji** i cili merret prej pusit te hapur prej vete pronarit.

1.4. MBETJET DHE EMETIMET NE MJEDIS

Me poshte jepet nje pershkrim i detajuar i mbetjeve dhe shkarkimeve te tyre ne mjedis, sipas etapave te procesit, natyres, sasive te tyre dhe drejtimet ne te cilat ato shkarkohen se bashku me efektet e mundshme te demshme qe mund te krijohen per tani dhe per nje te ardhme te larget.

Mbetje te ngurta

Mbetje te ngurta nuk gjenerohen pasi i gjithë materiali peroret per prodhim betoni te markave te ndryshme. Gjithashtu mund te permendim qe nuk kemi emetim te pluhurave sepse sic e shpjeguam he me siper, kjo firme aplikon teknologji te njome e cila nuk lejon ngritjen e pluhurave ne ambientet e punes.

Mbetje te lengeta

Mbetjet e lengeta qe dalin nga ky aktivitet nga proceset teknologjike shkarkohen ne kanalet e brendshme, dekantojne ne dy puseta dhe prej andej derdhen ne kanal in kullues me ane te cilit perfundojne ne ujembledhes.

Mbetje te gazta

Mbetje te gazta dalin gjate punes se automjeteve qe vijne dhe ato qe largohen nga linja e prodhimit te betonit, qe qarkullojne neper sheshin e objektit per transport materialesh, clirohen gaze te djegjes se karburanteve, te cilat jane te rralla dhe nuk perbejne problem per tu vene ne dukje.

Zhurmat

Zhurmat krijohen nga makinerite qe bejne te mundur prodhimin e betonit, ku permendim ketu dhe autobetonieret. Megjithate ato jane ne nivel te pranueshem dhe per personelin qe punon brenda, madje dhe per mjedisin rrethues.

SEKSIONI 2

PËRSHKRIMI I VENDIT DHE I MJEDISIT TË TIJ

Linja e prodhimit te betonit ndodhet ne lagjen" 10 Korik" ne zonen ne poligonin e ndermarrjes " Perlat Rexhepi", Vlore.

Sheshi i ndertimit kufizohet:

Veri→ Prone private

Jug→ Prone private

Lindje→ Rruge

Perendim→ Perroi



2.1 Popullsia ekzistuese me perafersi ne rethine e Vlores

Rrethi i Vlores aktualisht eshte e populluar me rreth 140.000 banore dhe me siperfaqe me perafersi 160.900 Ha. Banoret ne kete zone jane autoktoe qysh prej prej shume vitesh por vitet e fundit nga levizjet demografike ka ndodhur qe te kemi dhe nje perqindje te ndjeshme te popullsise me origjine rurale shume kane ikur ne qytetin e Vlores .

Ne portin e Vlores vitet e fundit ka nje rritje te ndjeshme te levizjes se qytetareve per ne vendet fqinje por dhe te levizjes turistike vendas e te huaj.

Ky fakt ka bere qe ne Vlore te kemi nje rritje te levizjeve te mjeteve transportuese te udhetareve, gje qe kerkon edhe nje sherbim per trajtim mjedisor me te mire pasi volumet e mbetjeve nga veprimtaria njerezore eshte rritur ne menyre te ndjeshme. Sasite e mbetjeve sipas llojeve jane pasqyruar ne plan biznesin qe eshte bashkengjitur raportit mjedisor.

2.2 Flora, faune dhe habitatet e qytetit te Vlores

Vlora karakterizohet nga nje larmi llojesh floristike natyrore por edhe te kultivuara, nje larmi shume te pëakte te llojeve faunistike kryesisht shtepiake e bujqesore si dhe te nje shumellojshmerie morfografie habitatesh. Eshte ne nje nivel lart llojshmeria e gjallesave ne mjedisin tokesor e detar e qe kerkon sigurimin e nje niveli te larte te kushteve mjedisore . Keta elemente mjedisor te zones ne fjale perbejne nje pasuri natyrore ekonomike dhe turistike me vlere te larta. Larmia gjeografike perfshin nje larmi habitatesh si ekosisteme me karakteristika specifike floristike e faunistike por qe ne kompleks eshte nje habitat natyror vlonjat me vlere te larta mjedisor e per rrjedhim edhe per nje zhvillim te qendrueshem ekonomim per zonen e kurores se lagunes se nartes, por njekohesisht edhe nje pasuri me vlere kombetare. Nderhyrja ne kontrollin e ketyre aktiviteteve qe po ushtrohen ne ne kete zone, e duke patur parasysh mbrojtjen e mjedisit si nje ekosistem kompleks nepermjet mosndotjes se saj ashtu sic eshte pershkruar ne projektin teknologjik te paraqitur me siper, nuk do te coje ne impakte te nivelit te tjetersimit te gjeomorfografise ekzistuese dhe as te

impaktit negativ ne mjedisin. Sigurisht si cdo nderhyrje do te kete dhe impaktin e vete negativ por qe ky impakt do te jete ne nivele shume te vogla, praktikisht zero.

Njekohesisht neperjet masave per zvogelimin e ndikimeve negative qe do te zbatohen gjate ketij aktiviteti do te bejne te mundur qe impakti ne gjeomorfologjine si dhe gjeomorfografine e kesaj zone do te jene shume minimale e praktikisht zero. Ruajtja dhe mireadministrimi i gjeomorfografise se zones ku kryhet ky aktivitet , nuk do te demtohet ne asnje menyre ne nivelin e tjetersimit te gjeomorfologjise e as te gjeomorfografise se kesaj zone. Edhe pse informacioni i hollesishem mbi biodiversitetin ka te cilat po i paraqitim te cilat jane nje pasuri e madhe e kesaj zone E gjithë zona dallon per nga diversiteti i habitateve dhe pasuria ne specie te flores dhe faunes. Shume prej tyre kane nje status ruajtje ose jane te rrezikuara ne nivel kombetar, nderkombetar dhe rajonal. Ne zonen e projektit eshte rang i gjere habitatesh tipike per zonat ligatinore: shkurre mesdhetare, dhe makia ne vargun e kodrave, pyje aluviale qe kufizojne lumin Vjose, zona me uje te fresket ne kodrat e Zverncit ose Panajase, lagunat bregdetare te Nartes e Kallenges, fushat e kripura te Akernise etj. Pasuria e habitateve shpjegon dhe prezencen e nje numri te madh speciesh vertebroresh dhe jo-vertebroresh te tille si zogj, gjitare, zvarranike, insekte dhe peshq.

Flora

Flora dhe vegetacioni eshte shume e pasur dhe interesante. Per zonen njihen rreth 1,400 **vascular plant species** (baraz me 42.4% te flores Shqiptare). Te gjitha keto specie bimesh perbejne nje pasuri te madhe kombetare. Disa prej tyre jane shume te rralla, disa te tjera kane vlera shkencore, nje numer i madh i tyre perdoret si bime mjekesore, aromatike, industriale, ushqimore dhe decorative.

Narta strehon XX taxons te rrezikuara ne shkalle kombetare

Table .Bime te rrezikuara ne zonen e Vjose-Nartes

Taxon	Statusi i rrezikut	Shperndarja
<i>Origanum vulgare</i>	EN	Ne makiat mesdhetare dhe pyjet
<i>Orchis sp</i>	EN	E gjithë zona
<i>Olea europea var. sylvestris</i>	VU	Ne makiat medhetare dhe pyjet
<i>Ceratonia siliqua</i>	EN	Ne makiat medhetare dhe pyjet

Rreth 25 specie bimesh ose 7.5% te numrit total te specieve bimore te rrezikuara te Shqiperise (330 specie ne total) takohen ne kompleksin e ligatinave. Mes tyre, 9 Specie jane te rrezikuara ne shkalle lokale ndersa dy specie jane endemike per Shqiperine

Table . Specie Bimesh te Rrezikuara ne Shkalle Komebetare dhe Lokale

o.	Emri Latin	Te rrezikuara	Vendn dodhja
	<i>Agrimonia eupatoria</i> L.	Rre	
	<i>Ammophila arenaria</i> (L.) Lb.	Rre	
	<i>Anacamptis pyramydalis</i> (L.) Rich.	Rre	
	<i>Baldellia ranunculoides</i> (L.) Parl.	D, R	
	<i>Butomus umbellatus</i> L.	D	
	<i>Cladium mariscus</i> (L.) Pol.	D	

	<i>Desmazeria marina (L.) Drude.</i>	Rre, R	Vjosa -Treport
	<i>Elymus farctus P.B.</i>	Rre	
	<i>Ephedra distachya L.</i>	Rre, R	Vjosa -Treport
0	<i>Hydrocotyle vulgaris L.</i>	Rre	
1	<i>Hypericum perforatum L.</i>	Rre	
2	<i>Marsilea quadrifolia L.</i>	D, R	Zverrn ec
3	<i>Narcissus poeticus L.</i>	R	
4	<i>Nuphar lutea (L.) Sibth. & Sm.</i>	D, R	Vjosa e Vjeter
5	<i>Nymphaea alba L.</i>	D, R	Vjosa e Vjeter
6	<i>Nymphoides peltata O.Kuntze.</i>	D, R	
7	<i>Orchis albanica</i> Goelz & Reinhard.	Rre, End	Poro
8	<i>Orchis coriophora L.</i>	Rre	
9	<i>Orchis x paparisti</i> Goelz & Reinhard	Rre, End	Poro
0	<i>Origanum vulgare L.</i>	Rre	
1	<i>Pancratium maritimum L.</i>	Rre, R	Zverrn ec
2	<i>Quercus robur L.</i>	Rre. x?	Poro
3	<i>Serapias lingua L.</i>	Rre	
4	<i>Spiranthes spiralis Koch.</i>	Rre	
5	<i>Stachys maritima L.</i>	Rre	

E –te Rrezikuara, V- te Dobeta, R – Rralla. End- Endemike

Me interes te madhe eshte prezenca e dy specieve endemike:
Orchis albanica dhe forma hybride *Orchis x paparisti*.

68 specie jane te konsideruara si te vlefshme ne zonen e Nartes per vlerat dhe interesin e tyre ekonomik dhe shkencor .

Fauna

Sic thame dhe me lart, kompleksi i ligatinave Vjosa-Narta eshte nje zone e rendesishme me shperndarje te nje numri te madh kafshesh duke perfshire edhe molusqe, insekte, peshq, amfibe, reptile, gjitare dhe ne menyre te vecante zogj. Sipas studimeve te kaluara (Raporti i Diagnostikimit te Zones) kompleksi i ligatinave strehon te pakten 741 specie kafshesh ose vertebroresh (Tab.).

Table . Kafshe prezentene kompleksin e ligatinave te Vjose-Narta

Group speciesh	Te rrezikuara Komb.	Te rrezikuara Glob.	Statusi i mbrojtjes	Nb. f species
Mollusqe	12	-		36
Insekte (Lepid & Coleopt)	57	1	28	287
Krustace	9	-		61
Echinoderms	6	-		6
Peshq	16	5	1	90
Amfibe	9	2	5	9
Reptile	23	5	20	26
Zogj	43	4	52	194
Gjitare	14	9	12	32
Total	189	26	118	741

Nje numer i madh speciesh i perket kategorive te rrezikuara ne shkalle kombetare dhe nderkombetare. Narta strehon 26 specie Globalisht te Rrezikuara (tabela X dhe X) per kete arsye eshte nje zone ruajtja e te ciles eshte me interes nderkombetar. Per me teper kompleksi regjistron 174 specie qe perbejne nje shqetesim Kombetar per zhdukje dhe meritojne perpjekje kombetare per ruajtjen e zones. Rendesia e zones tregohet gjithashtu nga prezenca e 118 specieve te mbrojtura ne shkalle kombetare dhe nderkombetare. Laguna e Nartes eshte nje pike e forte e biodiversitetit ne Shqiperi.

Tabela . Specie Globalisht te Rrezikuara

Nr.	Specie	Kategori Globalisht te Rrezikuara
1	<i>Lycaena ottomanus</i>	VU
2	<i>Acipenser sturio</i>	EN
3	<i>Alosa fallax nilotica</i>	DD
4	<i>Aphanius fasciatus</i>	DD
5	<i>Atherina boyeri</i>	DD
6	<i>Gambusia affinis</i>	EN
7	<i>Hyla arborea</i>	LRnt
8	<i>Triturus cristatus</i>	LRcd
9	<i>Caretta caretta</i>	EN
10	<i>Dermochelys coriacea</i>	CR
11	<i>Elaphe situla</i>	DD
12	<i>Emys orbicularis</i>	LR/nt
13	<i>Testudo hermani</i>	LR/nt
14	<i>Pelecanus crispus</i>	LR/cd
15	<i>Haliaeetus albicilla</i>	LR/nt
16	<i>Aquila clanga</i>	VU
17	<i>Falco naumanni</i>	VU
18	<i>Rhinolophus blasii</i>	LRnt
19	<i>Rhinolophus euryale</i>	VU
20	<i>Rhinolophus ferrumequinum</i>	LRcd

21	<i>Myotis myotis</i>	LRnt
22	<i>Microtus (Pitymys) felteni</i>	LRnt
23	<i>Microtus (Pitymys) thomasi</i>	LRnt
24	<i>Mus spicilegus (abbotti)</i>	LRnt
25	<i>Lutra lutra</i>	VU
26	<i>Stenella coeruleoalba</i>	LRcd

Ex – Te zhdukura; **CR** – Ne rrezik Kritik; **EN** – ne Rrezik; **VU** – te dobeta; **DD** – mungojne te dhena; **LR/cd** – Rrezik me i Vogel varen nga ruajtja; **LRnt** - Rrezik me i vogel gati te rrezikuara;

Amfibe dhe Reptile

Disa nga speciet jane te rrezikuara ne shkalle kombetare dhe nderkombetare. Eshte me vlere te permendet prezenca e specieve Globalisht te rrezikuara te Bretkoses se pemes Europiane *Hyla arborea*, **Loggerhead** *Caretta caretta*, breshka e tokes *Testudo hermanni*

Zogj

Te dhenat e vitit te kaluar tregonin Narten si zonen e dyte me te rendesishme per zogjte e ujit ne Shqiperi, me Karavastane ne vend te pare. Ne dimer me shume se 23% e te gjitha zogjve te ujit Shqiptar strehoen ne zone. Per me teper se 35 specie zona mban me shume se 6% te numrit kombetar (Tabela). Per Flamingo *Phoenicopterus ruber roseus*, **Shelduck** *Tadorna tadorna*, **Pintail** *Anas acuta*, **Goldeneye** *Bucephala clangula*, **Kentish Plover** *Charadrius alexandrinus* dhe **Golden Plover** *Pluvialis squatarola*, Narta eshte zona dimeruese me e madhe ne Shqiperi. Eshte me vlere permendja e prezences se Pelikanit Kacurrel *Pelecanus crispus* (9%) dhe **Audouini's Gull** *Larus audouinii* (100%), te dyja specie te konsideruara Globalisht te Rrezikuara

Table . Rendesia Kombetare e Nartes per zogj uji dimerues Informacion kombetar (Bino te papublikuara)

<u>Specie</u>	<u>Kombetare %</u>
<i>Podiceps cristatus</i>	15.40
<i>Phalacrocorax carbo</i>	19.02
<i>Pelecanus crispus</i>	8.97
<i>Ardea cinerea</i>	14.29
<i>Phoenicopterus ruber roseus</i>	50.85
<i>Anser albifrons</i>	31.58
<i>Tadorna tadorna</i>	41.18
<i>Anas penelope</i>	35.10
<i>Anas crecca</i>	29.57
<i>Anas platyrhynchos</i>	20.60
<i>Anas acuta</i>	42.16
<i>Anas clypeata</i>	17.30
<i>Aythya ferina</i>	8.50
<i>Bucephala clangula</i>	42.34
<i>Mergus albellus</i>	16.67
<i>Mergus serrator</i>	16.15
<i>Fulica atra</i>	21.96
<i>Haematopus ostralegus</i>	21.62
<i>Vanellus vanellus</i>	21.73
<i>Charadrius hiaticula</i>	14.29
<i>Charadrius alexandrinus</i>	53.68
<i>Pluvialis apricaria</i>	66.59

<i>Pluvialis squatarola</i>	35.66
<i>Calidris minuta</i>	41.73
<i>Calidris alpina</i>	41.72
<i>Numenius arquata</i>	7.76
<i>Tringa erythropus</i>	9.03
<i>Tringa totanus</i>	31.57
<i>Tringa nebularia</i>	13.56
<i>Tringa ochropus</i>	26.47
<i>Actitis hypoleucos</i>	6.45
<i>Larus melanocephalus</i>	12.09
<i>Larus ridibundus</i>	28.37
<i>Larus genei</i>	16.41
<i>Larus audouinii</i>	100.00
Specie Totale	23.50

Per tre specie folenizuese (Tab.), **Kentish Plover** *Charadrius alexandrinus*, **Black-inged Stilt** *Himantopus himantopus* dhe **Avocet** *Recurvirostra avosetta*, Narta eshte zona me e rendesishme ne Shqiperi. Per speciet e tjera, Narta eshte zona e dyte me e rendesishme ne vend.

Tabel . Rendesia Kombetare e Nartes per zogj uji folenizues

Proporcione te shifrave kombetare sipas Tempelman & Defos du Rau 1998

Specie	Kombetare %
<i>Charadrius alexandrinus</i>	50
<i>Himantopus himantopus</i>	100
<i>Recurvirostra avosetta</i>	60
<i>Burhinus oedicephalus</i>	30
<i>Glareola pratensis</i>	25
<i>Sterna hirundo</i>	10
<i>Sterna albifrons</i>	40

Biodiversiteti i kesaj zone nuk do te demtohet nga presionet njerezore.

Ne procesin tregetimit me pakice dhe shumice te materialeve te ndertimit nuk do te kete praktika te papershtashme si shpyllesim nhdertime e asnje lloj tjeter praktike demtuese te cfaredo lloji.

Per biodiversitetin e zones te asaj te depozitimit te mbetjeve ku do te operoje shoqeria, nuk do te kete ndotje e as eutrofikim nga ujrat e zeza te patrajuara, nga plehrat kimike e pesticidet.

Nuk do te kete shkaktim te gryerjeve e rreshqitjes e tokes.

Lidhur me floren e ne vecanti te asaj perreth zones ne menyre te pergjithshme mund te themi se dallohet per nje pasuri me vlera te vecanta pasi aty kryesisht bimesia eshte e dominuar nga lloje te bimeve barishtore spontane e pjeserisht nga bime shkurore e drunore te kultivuara dekorative.

Duke u munduar per te paraqitur nje inventarizim te bimesise mund te rendisim keto lloje bimesh:

- 1- Bime te familjes Graminaceae, bime barishtore te dominuara nga lloji I Grami, por dhe bime si lloje zambakore si dhe bime te tjera njevjecare e shume vjecare te pa determinuara.
- 2- Bime Konifere, gjinia Pinus me llojet P, nigra, P halepensis, gjinia Abies (bredhat), A Alba, gjinia Cupresus me llojin C, Sempervirens, dhe bime te tjera me popullime shume te vogla dhe pa ndonje rendesi te vecante qofte ekonomike, mjekesore apo dhe studimore .Ka gjithashtu edhe nje larmi bimesh dekorative sidomos te luleve te shumellojshme e te pa percaktuara si lloje.
- 3- Nuk ka bime te rendesise se vecante apo bime ne rrezik te shdukjes.

Nga pikpamja e llojshmerise se faunes konstatohet se persa i perket gjallesave te invertebroreve jane po ato te gjitha qytetit, por duhet vene ne dukje se popullata e llojeve invertebrore jabne te vogla pasi ky fakt lidhet me parametrat e faktoreve ekologjike qe jane me te pafavorshem pasi kjo gje eshte e shkaktuar nga vete urbanizimi i nje qyteti. Larmia e llojeve te vertebroreve eshte perseri relativisht ulet per faktin se kushtet e shfrytezimit te tyre eshte shume i vogel e kjo per arsye te nje qyteti urban sic eshte Vlora. Shumica e faunes paraqitet me popullata te vogla por qe urbanizimi i qytetit ndikon direkte ne mos mbijetesen e llojeve natyrore dhe ne mos mbareshtimin e atyre te kultivuara. Persa i perket popullatave te flores dhe faunes detare themi se ato jane te larmishme e ne vecanti te asaj ihtike por se rezervat e ketyre popullatave jane ne kufij minimal dhe si pasoje ndikim ne to eshte paraprakisht zero.

Veprimtaria e firmes " Memetaj 2002 " sh.p.k..ne zonen ku flitet do te realizoje pikerisht ruajtjen e mjedisit nga ndotjet e mundshme te shkaktuara nga aktiviteti qe kryen.

2.2 Tokat, kategoria e tokes gjeologjia dhe morfologjia

Dihet se gjendja e tokes eshte e rendesishme per bujqesine per pylltarine dhe biodiversitetin, dhe nga ana e tyre keta jane te rendesishem per ekonomine, shendetin publik dhe turizmin. Veprimtaria e firmes ne fjale nuk kerkon toke ne perdorim per asnje lloj aktiviteti, porse e vetmja siperfaqe tokesore qe perdoret nga firma eshte ajo ku kryhen proceset e ndryshme dhe e sheshit jashte godines i cili sherben per parkimin e automjeteve qe do te transportojne ullinjtper perpunimin e tyre ne fabrike dhe vajin e ullirit te prodhuar drejt destinacionit perkates. Ne siperfaqen e tij marrin pjese depozitimet me moshe te Miocenit e Pliocenit qe perfaqesojne strukturat e Ultesires Praneadriatike te perbera nga shkembinjte rrenjesore argjilo-alevreolitore, ranor e konglomerate, qe kryesisht jane te perhapur ne pjeset anesore te rajonit, kryesisht ne lindje te tije.

Gjithashtu marrin pjese edhe depozitimet Kuarternare qe mbulojne pjesen fushore te rajonit te perfaqesuara nga sedimente detare te Pleistocenit dhe detare e kontinentale te Holocenit.

Stratigrafia

Sistemi Neogenik – N

Depozitimet e sistemit neogenik perhapen ne pjesen lindore dhe jugperendimore te rajonit dhe perfaqesohen nga depozitimet e seksioneve te Miocenit dhe Pliocenit. Ato perbejne bazamentin ku vendosen depozitimet e kuarternarit dhe nuk jane objekt i studimit tone.

Seksionit Miocen – Pliocen N_1-N_2

Depozitimet e ketij seksioni jane te perfaqesuar me depozitime te nenseksionit te mesem dhe te siperm dhe perkatesisht te kateve Serravalian dhe Tortonian.

Kati Serravalian – N_1^{2S}

Ne siperfaqe takohet ne rajonin e kodrave te Zvernecit nga Kepi i Triportit ne juge deri tek Kepi i Dajlanit ne veri. Ne rajon nuk zhvishet e gjithë prerja, mungojne pjesa e poshtme dhe maja e saj, kalimi per ne depozitimet e katit Tortonian (per efekt te pranise se shkeputjes tektonike). Litologjikisht perfaqesohen nga pjesa e poshtme me ranore masive deri shtrese trashë te nderthurur nga shtresa te holla argjilash alevritike e mergelore. Ranoret paraqiten kokrriz vegjel e mesem, rralle kokrriz trashë e me madhesi gravelitike. Kane ngjyre hiri, e vende vende me nuanca te murme. Verehen gjithashtu mbeturina bimore te qymyriзуara si dhe konkrecione hekurore.

Me siper vijon normalisht pakua e argjilave dhe alevroliteve te nderthurura me shtresa te rralla ranore. Argjilat paraqiten alevritike e karbonatike dhe qe kalojne ne mergele e alevrolite. Kane ngjyre te murme ne te gjelber, kompakte, shtresor ndryshem. Ne pjesen e siperm te kesaj pakoje vrehen shtresa ranore te shkrifet ngjyre hiri, ne te murme e ne te verdhe.

Kati Tortonian – N_1^{3t}

Takohet ne pjesen me lindore te kodrave te Zvernecit dhe pikerisht prane fshatit Zvernec. Kontakti me depozitimet e nenshtrira eshte tektonik. Prerja perfaqesohet nga pako e ranoreve dhe gelqeroreve ranore litotamnike me ndershtresa argjilash. Ranoret paraqiten kokrriz vogel, teper karbonate, ndersa gelqeror-ranoret litotamnike jane teper alevritike e argjilore. Keto nivele litologjike nderthuren nga argjila teper karbonatike qe kalojne ne mergele.

Bazuar ne foraminiferet e takuar, percaktohet mosha e tyre tortoniane e zones faunistike Globigerinoides obliques extremus,

Kati Messinian – N_1^{3m}

Depozitimet mesiniane dalin ne siperfaqe ne strukturen e Panajase dhe ne lindje te qytetit te Vlores ku dhe vrojtohet trashesia me e madhe e tyre. Prerja e plote e tyre ne siperfaqe nuk zhvishet, por eshte e hapur nga pusët e kerkimit te shpuar ne kete rajon. Perfaqesohen ne pjesen e poshtme nga nderthurje te ranoreve me argjila hiri ne te kalter, me shtresezime te qarta. Ne vijushmeri, me larte vrojtohet prerja gipsmbajtese ku dallohen dy paketa gipsesh te ndara nga nje pako argjilo-alevritke. Prerja e Messinianit mbyllet me nje pako argjilash e alevrolitesh me ndershtresa ranore.

Seksioni Pliocenik – N_2

Perhapjen siperfaqesore depozitimet e seksionit pliocenik e kane ne pjesen lindore te rajonit dhe jane te perfaqesuara litologjikisht ne dy litofacie te emertuara suita Helmesi dhe Rrogzhina.

Suita Helmasi – H_2^H

Takohet ne siperfaqe ne strukturen e Panajase dhe kodrat e Aliban-Akernise. Shtrihet mbi depozitimet mesiniane here here me transgresion. Ato jane te perfaqesuara nga argjila masive, te hirta e me nuanca te kalterta qe permbajne shtresa ranore dhe thjerze konglomeratesh sidomos ne pjesen e poshtme te cilet paraqiten jo shume kompakt.

Ne pjesen me te siperme te prerjes shtohet prania e alevroliteve dhe ranoreve gadi gradualisht per te kaluar ne suiten Rrogozhina.

Suita Rrogozhina - N₂^{Rr}.

Depozitimet e suites Rrogozhina kane perhapje te madhe ne strukturen e Panajase. Vendosen suksesivisht mbi depozitimet e suites Helmesi.

Ne rajonin e Panajase perfaqesohet nga nderthurje te ranoreve te hirte e verdhacake, te shkrifet, kokrriz vogel, me argjila karbonatike e alevritike dhe qe vende vende kalojne ne mergele.

Sistemi kuaternar – Q

Depozitimet kuaternare perhapen ne siperfaqen me te madhe te rajonit, ato mbulojne strukturat antiklinale dhe sinklinale te ultesires Pranadriatike. Bazuar ne te dhenat fushore ku jemi mbeshtetur ne kampionet e zgjedhur ne zhveshje siperfaqesore dhe ne dheun e nxjerre nga kanalet e bonifikimit te fushes qe i perkasin pjeses 2 deri 3 m nen siperfaqen akuale te tokes dhe mendojme se perfaqesojne sedimentet kuaternare te formuara ne kondita detare.

Prezenca ne rajon e depozitimeve te Pleistocenit dhe Holocenit faktohet nga analizat paleontologjike te kampioneve te analizuara. Megjithate ne rajon eshte shpuar nje numur i madh pusesh me qellime hartografimi, strukturale, kerkim uji te pijshem, kerkim gazi metan. Keto shpime na kane siguruar vetem te dhena litologjike; ne mjaftete raste daljen nga depozitimet e Kuaternarit, ndersa te dhenat per argumentimin moshor te tyre jane te pakta .

Seksioni Pleistocen – Ne rajon perhapen vetem depozitimet e Pleistocenit te siperm.

II.B.1.a. Nenseksioni Pleistocen i siperm – Q₁²

Keto depozitime kane perhapje te gjere. Eshte koinçidence qe lumi Vjosa te veçoje keto depozitime ne dy sektore ato ne jug dhe ne veri. Per sektorin ne jug te lumit Vjosa perhapja e ketyre depozitimeve, duke filluar nga kufiri jugor i rajonit drejt veriut takohen te perhapura ne forme te nje rrypi te ngushte deri ne fshatin e Nartes, prej aty fillojne te zgjerohet per ne te dy anet e kenetes se Nartes deri ne afersi te Akernise dhe mandej kufiri i tyre hiqet sipas drejtimit perendimi i Akernise – Poro .Depozitimet e nenseksionit te Pliocenit te siperm jane takuar gjithashtu nga punimet e shpimeve te kryera per hartografim, kerkimin e ujit te pijshem dhe te gazit metan. Prerja ne pergjithesi eshte e perfaqesuar nga argjila – alevrolitore ne pamje te shtresave me trashesi 20-40 cm ne te cilat dallohen brezime te ndertuar me guacka te faunes te bivalvoreve qe i japin pamje shtresore depozitimeve, ne keto brezime takohen edhe zaje e guralec te shkembinjëve te ndryshem gelqeror e silicore. Argjilat ne pergjithesi kane ngjyre gri ne bezhe dhe gri ne kalteroshe te çelet, ne thyerje te fresket ato marrin ngjyra me te erreta (ndofta nga prania e lageshtise)

jane plastike e te perpunueshme me dore. Sipas te dhenave te puseve, depozitimet e Pleistocenit te siperm ndryshojne facien e tyre. Ne pjesen jugore te rajonit deri ne afersi te Nartes-2 prerja perfaqesohet me sedimente rerash te alternuar me thjerza argjilash dhe zhavoresh e deri konglomerat te çimentuar dobet veçanerisht ne bazen e vendosjes se ketyre depozitimeve.

Pothuajse ne te gjitha kampionet argjilore te analizuar per studimin e mikrofaunes nen mikroskop eshte dalluar edhe permbajtja e kristaleve te vegjel te kripes çka shton bindjen e formimit te tyre ne kushtet bregdetare e nje shelfi detar te brendshem.

Sipas percaktimeve faunistike te kampioneve te zgjedhur me siperfaqe na rezulton prania e foraminifereve, Ostracodeve qe perfaqesohen nga Cyprideis sp.sp., Lexoeoncha sp., Cytheridea aeuminata neapolitana Kollman,

Ne thellesi, bazuar ne te dhenat e shpimeve (Inkolenko A I, 1955; Makarov K K, 1968) pjesa me jugore e territorit ne juge te Nartes-Vlore kryesisht predominojne rerat me ngjyre gri te erret dhe gri te murme kokrrior mesem. Argjilat qe takohen alturnojne rerat, kane perhapje me te vogel ne juge te rajonit, por qe rritet sasia e tyre drejt veriut. Ato paraqiten ne trajte edhe te alevroliteve me ngjyre gri ne kalteroshe dhe gri te erret ne te gjelber karbonatore dhe qe permbajne mbeturina bimore te karbonizuara. Ne puse te veçante takohen edhe thjerza zhavoresh e sidomos prane daljes per ne shkembinjte rrenjesore. Zhavoret perbehen nga zaje te rrumbullakosur te shkembinjeve te ndryshem kryesisht sedimentar, karbonatike, shpesh te perziera me rere.

Duke shkuar drejt veriut te rajonit dhe pikerisht prej profilit XV e ne veri dhe ne perendim te ngritjes se bazes se Kuaternarit (ne daljet e shkembinjeve rrenjesore prane Akernise), ne depozitimet e Pleistocenit mbizoterojne argjilat alevrolitore te alternuara me thjerza te rerave e zhavoreve. Prane bazes se depozitimeve te Kuaternarit vrojtohen (nga te dhenat e puseve te shpimit) kalime si ne horizontalitet e vertikalitet te prerjes zhavorore, reror e argjile-alevrolitore.

Zhavoret jane te perfaqesuar nga zaje te gelqeroreve e ranoreve te rrumbullakosur me diameter 3-4-5 cm me material reror ndermjet zajeve.

Ne keto depozitime jane takuar nje sasi e konsiderueshme si makrofauna e mikrofauna.

Seksioni Halocen – Q₂

Ka perhapje te gjere siperfaqesore dhe ne baze te kushteve te formimit perfaqesohet me te dy nenseksionet e tij, atij te poshtem me formime detare dhe formime kontinentale.

Depozitimet e Holocenit te mposhtem ne rajonin e studiuar mund te veçohen nga prania e faunes detare te ujrave te cekta te kripura te perfaqesuara nga Cyprideis sp.sp., Laxoconcha sp., (Ostracoda) dhe foraminifere si Ammonia tepida, A. beccarii, etj. te perziera me faunen liqenore (kontinentale) te perfaqesuar nga Ostracoda.

Nenseksioni Halocen i poshtem – Q₂¹

Ne siperfaqe pozicionohen ne lindje te Pleistocenit te siperm dhe zhvillimin me te madh e ka ne veri te lumit Vjosa. Kufiri me juglindore i perhapjes eshte ne lindje te kodrave te Alibanit prane Trevllazerit. Krahas takimit ne siperfaqe, keto depozitime takohen dhe ne thellesi nepermjet interpretimit te puseve te shpuar.

Kufiri i poshtem i tij ne siperfaqe eshte trasuar me interpretim ne baze te te dhenave te kampioneve te analizuar si dhe te karakterit litologjik te prerjes.

Ne harten gjeologjike jane perjashtuar te dhenat e pjeses me te siperme 1-2-3 m te prerjes se sotme kryesisht aluvione te vershimeve te lumenjeve Vjosa e Seman dhe jane marre ne konsiderate te dhenat e dheut te nxjere nga kanalet e bonifikimit te fushes.

Prerja e depozitimeve te Holocenit te poshtem eshte e perfaqesuar nga argjila-alevrolitore gri te çelet me nuanca bezhe dhe ne thyerje te fresket ngjyre te gjelbert te erret, ne te murme. Gjithashtu vrojtohen dhe mbeturina bimore ngjyre kafe, Me larte ne prerje (duke ju larguar kufirit Pleistocen te siper-Holocen i poshtem) prerja argjilo-alevritike paraqitet ne ngjyra kafe te çelet ne te murme dhe te verdhe, dallohen shtresezime paralele qe duhet te jene te lidhura me prezencen e materialit alevrit-rere e perbere nga mika te bardha. Shtresezimet jane horizontale.

Nen prerjen siperfaqesore te siperpermendur qe perben nje trashesi deri 2.5 m nga siperfaqja e tokes, ne puset e shpuar jane takuar depozitimet e Holocenit te poshtem, kryesisht jane te perfaqesuar nga argjila-alevritike te alternuara me thjerza rere si dhe me kalime te alevriteve e rerave te holla. Ne rajonet lindore e veçanerisht ne gropen ne lindje te kodrave te Akernise shpesh predominojne rerrat me thjerza te argjilave-alevrolitike.

Pjesa e poshtme e ketyre depozitimeve e kapur nga puset perfaqesohet nga sedimente argjilo-alevrolitore me trupa deri ne thjerza te kufizuara te rerave. Keto vendosen mbi nivelet e zhavoreve te takuar ne pjesen e siperme te Pleistocenit.

Argjilat-alevrolitore me grumbullime te rerave predominojne ne prerje dhe paraqiten gri ne hiri e te murme, me copra e guacka makrofaunash dhe mbeturina bimore te karbonizuara. Rerrat paraqiten gri ne kafe, ne te verdhe me madhesi te ndryshme kryesisht kokrriz vogel e mesem.

Trashesia e thjerrzave te ranoreve ne puset e shpimit arrin deri 2.0 m.

Bazuar nga te dhenat e shpimeve te kryer per pjesen me ne thellesi te ketyre depozitimeve rezulton prania e argjilave alevritike gri ne hiri e kalteroshe me nivele te rerave gri ne bezhe me kokrriza te vogla deri te mesme, me trashesi 1-1.5 m dhe me perhapje te kufizuara.

Nen seksioni Halocen i siperperm – Q₂²

Keto depozitime vendosen kudo me mospajtim dhe perfaqesohen nga depozitimet e aluvioneve, rerave bregdetare, dhe ato eluvion-deluvion-preluvioneve.

Depozitimet e rerave bregdetare - Q₂² (Rd)

Perhapen ne pjesen perendimore te rajonit, shtrihen paralel me vijen e bregut e te plazhit te detit ne forme te nje brezi me gjeresi qe ndryshon shtrirjen ne brendesi te tokes nga 500-1000 m ne 3000 m. Ky brez duhet te pasqyroje edhe levizjen e plazheve ne kohe.

Depozitimet e rerave bregdetare ne pergjithesi formojne plazhet e sotme si dhe zonat e ngritura te dunave. Ato perbehen nga rera ngjyre gri ne bezhe te çelur, kryesisht me kokrriza te vogla, shpesh me copra guacka bivalvoresh. Me teper predominojne grimcat e karbonateve, pa perjashtuar edhe kokrriza te mineraleve te rende e te rralla si te kromitit, ilmenitit, „rutili etj., nje pjese e mire e te cileve formojne dhe grumbullime industriale shkriferimesh si, prane rajonit Seman. Ato kane trashesi qe ndryshon nga 0 (ne lindje) deri 20 e 50 m ne perendim. Shpesh ne thellesi takohen perzjerje argjilore si dhe mbeturina bimore.

Keto depozitime duke i menduar te formuara ne kushte detare e lagunore i konsiderojme me origjine detare.

Per token dy jane problemet kryesore dhe me shqetesuese : Erozioni dhe prishje e cilesise se tokes.

EROZIONI:

Megjithese ne nje shkalle te kufizuar, erozioni eshte nje fenomen natyror ne zonen e studimit, duke patur parasysh karakteristikat gjeologjike, fizike dhe kushtet klimaterike te zones. Eshte e verejtur kryesisht ne vargun kodrinor i cili perben kufirin lindor te zones se projektit.

Erozioni eshte nje fenomen i koheve te fundit i nxitur nga prerjet pa kriter, mbi kullorja, dhe zjarret. Dhe eshte sigurisht nje problem per tu marre ne considerate ne planin e menaxhimit. Rehabilitimi i habitateve te degaduara do te parandalonte erozionin i cili po behet nje fenomen i zakonshem ne zone.

Edhe pas ushtrimit te veprimtarise nga shoqeria nuk do te kete rritje te shkalles se erozionit nuk do te rritet me shume nga ajo qe do te kete ne kushte natyrore. Per ushtrimin e veprimtarise tregetare nga shoqeria nuk do te kete shpyllezime, nuk do te kete rritje te humbjes se tokes asnje ton/ hektare ne nje vit.

Nga ushtrimi i veprimtarise tregetare ne zonen portuale ku do te operoje si dhe ne fushen e magazinimit te materialeve per ndertim nuk do te kete prishje te cilesise se tokes dhe humbje te pjellorise pasi nuk do te preken nga nderhyrja, nuk do te shtohet as rreziku i rreshqitjes se tokes dhe humbje te saj. Nga ky aktivitet do te operoje shoqeria nuk do te kete depozitime te sedimenteve ne ujrave te kanalizimeve te ujrave te zeza as dhe te ujrave te bardha e qe mund te ndryshojne rrjedhen e tyre natyrore, bllokimin e tyre apo dhe ekologjine e tyre. Nuk do te kete ndikime ne vellimin e ujrave rrjedhese (te kanalizimeve te qytetit) apo atyre ne dispozicion te furnizimit per vaditje e as ne furnizimin me uje te pijshem.

Me masat qe do te merren nga shoqeria qe po punon niveli i transportimit te sedimenteve nepermjet ujrave rrjedhese per ne zonen bregdetare te qytetit do te jete pothuaj zero e nuk do te kete ndikime negative ne jeten nenujore detare, apo te ndonje lagune e as ne gjendjen e plazheve te Vlores.

2.4 Cilesia e tokes

Tokat ekzistuese qe po punohet ne zone sot per sot jane ne gjendje te pranueshme pa ndotje pasi nuk ka aktivitete industriale. Edhe pas veprimtarise toka si mundesi per shfrytezim te cfaredo lloji aktiviteti si ai bujqesore apo ai ndertimor nuk do te kete demtime te cilesise nga asnje lloje ndotje ku substancat ndotese te arrijne te hyjne ne zinxhirin ushqimor e me pasoja per shendetin e njerezve.

Nuk do te kete hedhje te pakontrolluar te mbetjeve urbane te cilat te sherbejne si ushqim per kafshet apo te ndotin token.

2.5 Uji , akuiferet shkarkimet e mundshme ekzistuese

Zona ku operon firma nuk eshte e njohur per burime ujore natyrore ashtu dhe me ujera te nendheshem mund ta kene zanafillen e tyre nga lartesia e kodrave perreth ..

Ujrat qe shfrytezohen nga firma per larje te ndryshme dhe te proceseve te tjera teknologjike ne zonen qe punohet jane ato qe vijne nga pusi i hapur nga vete pronari i shoqerise.

Ne kete zone nuk ka shfrytezim te rezervave te ujrave nentokesore me ante te puseve per asnje lloj perdorimi si per perdorim familjar ashtu dhe bujqesor. Eshte e kuptueshme se nuk ka mbishfrytezim te rezervave ujore e te burimeve nentokesore.

Me ushtrimin e aktivitetit tte caktuar nga ana e shoqerise eshte e kuptueshme se nevojat per ujin do te jene te domosdoshme dhe do te rritet konsumi i ujit por sasite e nevojshme nuk do te ndikojne ne rezervat ujore te ujit te pijshem per popullatene.

Pavaresisht nga mungesa e nje informacioni per perlllogaritjen e sasive te rezervave te ujrave ato jane nje potencial i mundshme qe duke respektuar legjislacionin per shfrytezimin

e tyre te mundesohet nderhyrja nga shoqeria qe do te paraqesi kerkese me pare te pajiset me Leje Mjedisore te miratuar nga Ministria e Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.

Burimet ujore natyrore ekzistuese te zones kane perdorim per ate familjar te qytetit dhe tepricat e tyre perdoren edhe per perdorim urban qe aktualisht eshte ne sasira shume te pakta. Rruget e gjithe ujrave te burimeve natyrore aktualisht jane ne gjendjen e tyre sipas rrjetit hidraulik te qytetit dhe veprimtaria tregetare e shoqerise nuk do te kete asnje lloj ndikimi lidhur me demtimin apo me ndonje nderhyrje te pa ligjshme.

Nga veprimtaria e shoqerise ne zonen e caktuar nuk do te kete asnje lloje nderhyrje qe te devijojne rruget e shkarkimeve te ujrave te qytetit te cfare do lloji.

Per te siguruar cilesine e ujrave si shkarkime pas perdorimit te tyre firma detyrohet te siguroje te gjitha masat dhe proceset teknologjike qe te sigurojne ngarkesat e ujrave brenda normave te lejuara dhe pa perdorur kimikate te ndryshme.

Shkarkimet e ujrave siperfaqesore te ndotura nga aktiviteti duke perfshire cdo aktivitet tjeter ndotes detyrimisht do ti nenshtrohen te gjitha masave teknologjike e ligjore per te siguruar nivelin e ndotjes brenda normave te lejuara.

2.6 Ajri, cilesia e ajrit, faktoret klimatike

Gjate procesit te prodhimit te betonit nga firma ne zonen e percaktuar ka nje sere veprimtarish qe ndikojne negativisht ne cilesine e ajrit si pluhura, gaze nga makinerite e punes dhe ndotes te tjere. Per te evituar ndikimet negative per shendetin e qytetareve e ne vecanti te punonjesve gjate procesit te punes subjekti qe operon per kete aktivitet detyrohet te plotesojne nje sere masash teknike e organizative qe do te zbusin impaktin negativ per shendetin e njerezve si me poshte :

- a. Te perdoren pajisje qe blloktojne perhapjen e pluhurave me qellim qe treguesit e LGS –se ne atmosfere te jene jo me te larta se 80 mg / m³ qe eshte norme e lejuar ne vendin tone sipas BE.
- b. Vlera e PM 10 te jete jo me e larte se 50 mg / m³
- c. Punimet qe kane nje intesitet te larte te pluhurave te kryehn ne oret me te pake te qarkullimit te njerezve ashtu sic eshte parashikuar .
- d. Te evitohen ne kohe cdo lloje depozitimi te perkohshem te mbetjeve te ngurta qe jane burimi pluhurave.
- e. Mbetjet e ngurta te hidhen vetem ne vende te miratuara qe nuk jane burim ndotje per mjedisin.
- f. Po keshtu edhe per perdorimin e makinerive qe do te jene burim i ndotjes se ajrit me gaze te ndryshem te respektohen te gjitha masat per zbutjen e ndikimit ndotes te tyre.
- g. Firma "**Memetaj 2002**"SH.P.K. qe operon gjate veprimtarise se prodhimit te betonit te respektojne te gjitha masat teknologjike qe do te paraqesin ne raportet e VNM –se per pajisjen e tyre me leje mjedisore.

Pas perfundimit te veprimtarise te cdo dite te zones se percaktuar nuk do te jene te pranishme faktoret qe shkaktojne ndotjen e ajrit e nuk do te kete emetime te ndotesve te ajrit te asnje lloji.

Faktoret klimatike te zones qe do te pastrohet jane ato te nje klime mesdhetare te ndikuar nga lartesia e kodrave perreth duke krijuar nje dimer pa reshje debore e ngrica me temperatura qe nuk zbresin nen zero grade celsius per nje periudhe qe shkon nga muaji dhjetor deri ne shkurt mund te kete vetem pak dite me temperatura qe mund te zbresin nen zero.

Vera eshte e fresket deri ne te nxehte me temperatura mesatare rreth 24 – 26 grade e me pak rreshje.

Faktoret klimatike jane shume favorizues per biodiversitetin e ne vecanti per zhvillimine turizmit detar. Disa te dhena per klimen ne Rrethin e Vlores jane te peraferta me ato te zones Nr. 4 qe do te urbanizohet.

Rrethi	Reshjet Vjetore	Temperatura mesatare	Dite me diell	Dite me shi	Dite te vraneta
Vlore	1675 mm	16.4 c	229	44	95

2.7 Trashegimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike

Zonat ka nje paraqitje arkitektonike te larmishme ku dominohet nga ajo fushore me lartesi te kodrave perreth qe shkojne deri ne 150 m. Ne zonen qe operon shoqeria nuk ka ndonje trashegimi historike te vecante , po keshtu nuk do te kete as edhe zone arkeologjike qe te jete nen ndikimin e veprimtarise se prohimit te betonit nga e cila do te kete edhe ndonje demtim.

2.8 Pejsazhi

Zona ne te cilen firma "Memetaj 2002" po punon ka vlera te medha natyrore dhe piktoreske ne gjendje pothuaj te virgjjer por dhe te kultivuar qe ka mbijetuar pavaresisht nga presionet e njerezve qe jane ushtruar mbi te. Kjo zone edhe pas ushtrimit te veprimtarise nga firma ne fjale do te mbetet ne mbrojtje me qellim qe te ruhen vlerat e diversitetit biologjik si dhe bukuria natyrore e pejsazheve per brezat qe do te vijne. Nuk do te kete ndryshime te pejsazhit natyror ekzistues nga ushtimi i veprimtarise. Zona nuk ka ndonje status te vecante per tu mbrojtur, nuk eshte zone e mbrojtur me ligj, nuk eshte as ne rezervat kombetar natyror, nuk eshte zone me bukuri te rralle natyrore, nuk eshte park rajonal, as dhe rural nuk eshte rezervat natyror lokal, nuk ka ndertime me vlera, as monumente te lashtesise te cilat mund te rrezikohen nga veprimtaria e prodhimit te betonit. Aktiviteti ne kete zone eshte ne perputhje me politikat kombetare dhe ato lokale te zhvillimit te Vlores pasi eshte qytet me perparesi zhvillimin e turizmit.

SEKSIONI 3

VLERESIMI I NDIKIMEVE

Ky perfshin efektet direkte dhe indirekte, sekondare, te asimiluara, afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, te perkoheshme dhe te perhershme, pozitive dhe negative te projektit.

-Efektet mbi qeniet e gjalla, ndertesat dhe tipare te tjera te mjedisit te realizuara nga dora e njeriut

Veprimtaria e prodhimit te betonit nuk ka per baze asnje lloje perpunimi kimik apo biologjik si burim ndotjeje apo te cfaredo lloji tjeter demtimi sidomos te ekosistemit pyll apo te ekosistemeve te tjera perreth zones kontinentale.

3.1 Ndikimet ne popullsi

Linja e prodhimit te betonit nuk ndikon ne popullsine e zones, per pasoj nuk do te kete ndikime pasuese mjedisore.

Kjo sepse perreth zones nuk ka shume ndertesa banimi, pervec se veprimtari te tjera te cilat kryejne aktivitetin e tyre. Gjithashtu aktiviteti nuk shoqerohet me zhurma apo emetime te llojeve te tjera ne nivele te larta shqetesuese per banoret. Si ndikim pozitiv permendim punesimin e nje numri te vogel te punonjesve e cila zgjidh minimalisht nje nga problemet sociale siç eshte punesimi.

3.2. Ndikimet vizuale të aktivitetit në rajonin përreth dhe në pejsazh

Nuk ka ndikim negativ ne pejsazhin natyror te zones apo qytetit te Vlores apo dhe zones perreth duke shkaktuar tjetersime te pjesshme. Nga proçesi i linjes se betonit pejsazhi ne pergjithesi, nuk ka ndryshuar. Keshtu qe ndikimi i saj eshte i pa perfillshem.

3.3. Nivelet dhe ndikimet e emetimeve nga aktiviteti gjatë funksionimit normal

Siç , eshte parashikuar edhe me siper nga linja e betonit nuk ka emetim te pluhurave ne sektoret ku ndodh procesi i prodhimit dhe ngarkim-shkarkimi i materialit. Keto emetime evitohen si pasoj e teknologjise se njome qe aplikohet ne kete linje. Po keshtu emetime te pakta vine nga perdorimi i fadromes dhe makinave qe bien inertin lumore dhe transportojne inertet e prodhuara. Keto mjete qe emetojne sasira gazesh jane rezultat i punes se motorave me djegje te brendeshme , brenda normave te lejuara. Keto mjete para se te vihen ne pune jane objekt i kontrolleve teknike.

3.4. Nivelet dhe ndikimet e zhurmave te shkaktuara nga aktiviteti

Linja e betonit ,eshte proces qe realizohet ne anen e impiantit qe ne rastin konkret perbehet nga transportieret, betonieret, aksesore te tjere si dhe nga mjetet ndihmese te transportit qe jane fadroma dhe makina. Pra, siç shikohet i gjithe procesi i linjes e betonit, ngarkim dhe

transport eshte i mekanizuar dhe ka vetem mjete. Keto paisje dhe mjete persa i takon nivelit te zhurmave i kane brenda normave te lejuara pasi keto mjete transporti jane te kolauduara periodikisht.

3.5. Ndikimet e aktivitetit mbi rruget dhe transportin lokal

Linja e betonit ndodhet ne lagjen "10 Koriku" ne ane te rruges kryesore. Gjate kryerjes se aktivitetit nuk ka ndryshim te rrjetit te rrugeve lokale dhe transportit. Per rrjedhoje projekti nuk ka ndikime absolutisht ne rruget lokale dhe transport, perkundrazi subjekti eshte i detyruar te mirembaje rruget lokale te transportit me qellim mbarevajtjes se mire te aktivitetit te tij.

3.6. Ndikimet e aktivitetit mbi ndërtesat, thesarin historik dhe arkitektonik, vecoritë arkeologjike dhe shqetësime të tjera njerëzore

Aktiviteti linja e betonit zbatohet ne nje zone ne siperfaqjen e se ciles dhe ne nentoken e saj nuk ka ndertime trashgimie arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi veprat te tjera njerzore. Kjo tregon se zona eshte e lire jo vetem per te realizuar, linja e prodhimit te betonit por njekohesishte nje zone ne te cilen aktiviteti i prodhimit te betonit nuk ndikon aspak ne ndotjen e ajrit.

-Efekte mbi flore, faune dhe gjeologji

3.7. Humbje dhe demtime tek habitatet dhe speciet e tre qofshin bime apo kafshe

Zona ne siperfaqjen e te ciles eshte ndertuar linja e betonit, eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemete te flores, kjo sepse kjo zone eshte zone e banuar.

3.8. Humbje dhe demtime ne tipare gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike

Nuk ka humbje apo demtime te ketyre strukturave, gjithashtu nuk ka konseguenca te tjera ekologjike.

3.9. Rjedhoja te tjera ekologjike

Nuk ka.

-Efekte ne toke

3.10. Ndikime fizike te aktivitete (ndryshimi ne topografine lokale, humbja e stabilitetit te tokes, erozioni i tokes etj...)

Nisur nga teknologjia qe perdoret ne impiat, veme re se me zbatimin e projektit nuk kemi ndikime fizike te projektit siç mund te jete ndryshime ne topografine lokale, erozionin e tokes apo ndryshime te tjera te dukshme. Perkundrazi nga teknologjia e prodhimit te betonit

perfitohen materiale te cilat kalojne direkt ne shitje. Te gjitha sa me siper çojne njekohesishte dhe ne zbutjen e efekteve te erozionit lokal .

3.11. Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitime ne toke, ne vendin e aktivitetit dhe ne zonen perreth

Nuk do te kete emeteime kimike apo depozitime ne toke ne siperfaqjen ku eshte vendosur impianti dhe perreth tij. Siç, eshte pershkruar edhe ne projektin e prodhimit te betonit, ai eshte thjeshte nje proces mekanik duke perjashtuar elementet kimik .

3.12. Ndikimet e perdorimit te tokes/burimeve

Projekti per prodhimin e betonit dhe siperfaqja ku zbatohet ky projekt, perjashtojne ne menyre kategorike ndikimin ne cilesi dhe sasi te tokes bujqesore per vete faktin qe nuk zbatohet ne token bujqesore dhe se ndodhet ne distanc te konsiderushem larg tyre .

-Efektet ne uje

3.13. Efektet e aktivitetit mbi drenazhim

Tokat e zones nuk jane te drenazuara, pra nuk ka demtime te kesaj natyre

3.14. Ndryshime ne tipare te tjera hidrografike

Zbatimi i projektit ne lagjen "10 Koriku", ne rrugen" Perlat Rexhepi" nuk çojne ne ndryshimin hidrografik te nivelit te ujrave, te rrugeve ujore, te rrjedhjes se ujrave nentokesor dhe siperfaqesore etj.

3.15 Ndikime ne hidrologjinë bregdetare dhe grykëderdhjes së lumenjve

Veprimtaria nuk shkakton ndryshime te nivelit te ujrave tokesore as te drejtimit te rrugeve te tyre, po keshtu as edhe drejtimit te rrugeve te ujrave nentokesore

3.16. Ndikimet e ndotësve, mbetjeve etj në cilësinë e ujit

Aktiviteti i prodhimit te betonit nuk shoqerohet me mbetje apo shkarkime te ndryshme, te cilet ndotin elemente kryesor si uje, toka, ajri. Aktiviteti ne impiant eshte shume i thjesht. Ketu zbatohet teknologji qe ka te bej me ndryshime te ndryshme fiziko – mekanike, per pasoj nuk do te kemi ndotesa apo mbetje te cilet te demtoje cilesine e ujit , tokes , ajrit kimikisht .

-Efektet ne ajer ose klime

3.17. Niveli dhe perqendrimi i emetimeve kimike dhe efekteve mjedisore te vecanta

Aktiviteti i prodhimit te betonit eshte aktivitet i cili nuk shoqerohet me emetime kimike, per rrjedhoj nuk kemi te bejme me perqendrime, ndikime e tyre ne mjedis .

-Efektet e tjera indirekte dhe sekondare që shoqërojnë aktivitetin

3.18. Erërat që përhapen

Gjate veprimtarise si dhe gjate funksionimit te proceseve te prodhimit te betonit te ketij aktiviteti nuk perdoren lende te asnje lloji te vecante me natyre ndotese as lende me aroma sulmuese. Nuk ka asnje lloj tjeter ndikimi ne klimen e kesaj zone.

3.19. Ndikimet nga trafiku (rruqa , hekurudha , ajri , uji ,) qe lidhen me projektin

Meqense objekti eshte ndertuar ne ane te rruges kryesore "Perlat Rexhepi" mund te themi qe ky aktivitet nuk ka ndikim ne rritjen e trafikut.

3.20. Ndikimet e lindura nga grumbullimi dhe konsumimi i materialeve , ujit , energjise ose burimeve te tjera si pasoj e projektit .

Nuk ka.

3.21. Ndikimet e projekteve të tjera që e shoqërojnë si për shembull rrugët e reja , kanalet e ujrave të zeza , banesat , linjat e energjisë , naftë dhe gazsjellëse , tekekomunikacionit , etj

Nuk ka.

3.22. Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte të tjera ekzistuese ose të propozuara

Nuk ka.

3.23. Ndikimet sekondare që rezultojnë nga ndërveprimi i ndikimeve të tjera direkte të listuara më sipër .

Nuk ka.

SEKSIONI 4

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

KONKLUZIONE

- Veprimtaria nuk tjeterson siperfaqe te mjedisit me karakteristika te favorshme per popullime gjallesash natyrore apo te kultivuara.
- Veprimtaria qe kryen ky aktivitet nuk shkarkon ne mjedis lende te rrezikshme e nuk shkaktohen ndotje nepermjet mbetjeve mbi normat e lejuara.
- Veprimtaria qe kryen ky aktivitet, nuk ndikon ne perkeqesimin e parametrave optimale te treguesve mjedisor apo klimatik.
- Veprimtaria e ketij aktiviteti nuk ndikon ne vleresimin strategjik mjedisor te zones kontinentale as dhe te asaj detare me te cilin krijon lidhje indirekte

Bazuar ne normat e lejueshme te percaktuara nga ligjet perkatese mbi ndikimet ne mjedis, projekti i veprimtarise se prodhimit te betonit, nga pronari z. Arjan Memetaj dhe qe eshte paraqitur prane ARM-se Vlores per tu pajisur me Leje Mjedisore nuk shkakton ndotje te mjedisit pra nuk shkakton :

- ndotje te ujit te pijshem
- ndotje te ujrave siperfaqesore ose te atyre nentokesore
- ndotje te ajrit
- ndotje te tokes
- tjetersime te pejsazhit
- demtime te pyllit nepermjet prerjeve

Rezulton se veprimtaria e administruar nga pronari z. Arjan Memetaj

- nuk demton ekosisteme
- nuk demton burimet natyrore
- nuk demton zhvillimet social – kulturore te zones ku do te operoje apo te Bashkise se Vlores ku perfshihet kjo zone
- nuk do te kete demtim te tokes bujqesore
- nuk rrit dukurine e erozionit.

Ky aktivitet:

- Ndikon ne permiresimin e parametrave te komponenteve mjedisor te Vlores si qytet ne pergjithesi me perparesi zhvillimin e ndertimeve ne qytetin e Vlores .
- Realizon punesimin e nje numri te vogel banoresh

REKOMANDIME

Percaktohet te pershkruar gjate trajtimit te ketij raporti mjedisor eshte e rendsishme qe subjekti qe operone do te zbatoje :

- Masat tekniko organizative te pershkruara ne raportet e VNM- se
- Mbjajtjen ne gadishmeri te plote te sistemit te grumbullimit dhe largimit te mbetjeve te ngurta urbane te ngurta e te cdo lloji tjeter.
- Kryerja e punimeve me mjete e pajisje bashkohore qe shkaktojne ne minimum impakte ne mjedis.
- Te kryhen kontrollet e nevojshme te emetimeve dhe te kryhen analizat perkatese per te percaktuar nivelin e ndotjes per cdo lloj shkarkimesh dhe emetimesh ne mjedis nga mjetet dhe pajisjet teknologjike qe perdoren ne kete aktivitet .
- Te aplikohen masa te llojit estetik dhe ekologjik te pershtatshme, te parashikuara qysh ne raportin e VNM-se duke nenkuptuar elemente te tille si formim pejsazhi te ri te zones se grumbullimit te mbetjeve ute ngurta ne harmoni me mjedisin, krijim te brezave apo te siperfaqeve te mbjella me bimesi karakteristike te zones apo bime te kultivuara, ruajtja e mundshme e habitateve apo dhe krijimi i habitateve te reja e ne harmoni me mjedisin .

EKSPERT MJEDISOR

Studio "COMERCIR" sh.p.k

Msc. Ing. Apostol QIRKO

Msc. Ing. Athinta QIRKO



Vlore, 13.10.2014